

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Gjatë dekadave të fundit, shpeshtësia dhe intensiteti i fatkeqësive natyrore, shoqëruar me dëme të mëdha në burime materiale dhe fuqi njerëzore, është rritur ndjeshëm në nivel global dhe rajonal. Kjo situatë është përkeqësuar akoma më shumë për shkak të degradimit të mjedisit, ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Në një pjesë të madhe të rasteve, fatkeqësita natyrore janë shndërruar në katastrofa për shkak të shkallës së ulët të ndërgjegjësimit dhe mungesës së informacionit të komunitetit.

Në kushtet e rrezikut dhe emergjencave humanitare, personat me aftësi të kufizuara kanë më shumë të ngjarë të përballen me barriera dhe pengesa kundrejt mjedisit fizik, transportit si dhe informacionit dhe komunikimit.

Rreth 15 për qind e popullsisë së botës jeton me një formë të aftësisë së kufizuara. Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri mbi një bazë të barabartë me të tjerët.


INFORMACION MBI PROJEKTIN

Programi Ndërkufitar IPA II Greqi-Shqipëri 2014-2020, ka në fokus mbështetjen e vendeve ndërkufitare në reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive të shkaktuara nga shkaqe natyrore dhe shpesh edhe nga njerëzit. Në veçanti, zjarret dhe përmbytjet po rriten duke pasur ndikime ndërkufitare të cilat e bëjnë thelbësore një qasje të përbashkët.

Megjithëse përpjekjet për t'ju përgjigjur këtyre fenomeneve janë tashmë prioritet në të dy vendet, dokumente strategjike që kanë në vëmendje përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara apo moshën e tretë ende mungojnë, duke i lënë ata plotësish të ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta.


Në këtë kuadër, projekti 4PLUS, synon të zhvillojë një qasje gjithëpërfshirëse ku planifikimi i përgjigjës dhe gatishmërisë duhet të marrë parasysh kapacitetet dhe nevojat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara dhe të bëjë përpjekje të qëllimshme për të hequr pengesat fizike, të komunikimit dhe të qëndrimit për aksesin dhe pjesëmarrjen e tyre.

PROFILI I PAK NË BASHKINË KOLONJË




- Personat me të paktën një aftësi të kufizuar
- Personat me vështirësi në shikim
- Personat me vështirësi në dëgjim
- Personat me vështirësi në komunikim
- Personat me vështirësi në kujdesin e përditshëm
- Personat me vështirësi në kujtesë
- Personat me vështirësi në lëvizje

NDIHMA E NEVOJSHME NË AKTIVITETE TË PËRDITSHME



- Kujdesi personal (larje, veshje)
- Përgatitja e vakteve
- Lëvizshmëria (lëvizja nga shtratë në karrike me rrota ose në tualet)
- Marrja e medikamenteve ose për të kujtuar oraret e marries së tyre
- Përdorimi i telefonit
- Ecja
- Komunikimi me të tjerët (nevoja përkthyes)

AFTËSIA PËR TU EVAKUAR NË RAST FATKEQËSISH



- Po
- Me shumë vështirësi
- Jo

REKOMANDIME MBI MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE DHE EMERGJENCAVE

Aftësia e kufizuar duhet të kthehet në një çështje thelbësore, ndërsektoriale në menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencave.

Aftësia e kufizuar duhet të konsiderohet në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike në të gjitha aspektet e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive. Të gjitha llojet e aftësive të kufizuara duhet të merren parasysh.



REZULTATET E PROJEKTIT

- Shkëmbimi i njohurive dhe praktikave të mira midis partnerëve ndërkufitar;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoritetetë vendore në zonën ndërkufitare;
- Hartimi i udhëzuesve të përbashkët të përgatitjes dhe përgjigjes ndaj emergjencave civile me fokus personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit;
- Përgatitja ndaj fatkeqësive, edukimi dhe trajnimi i kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara si dhe punonjësve të qendrave sociale;
- Rritja e ndjenjës së sigurisë në nivel komuniteti dhe individi.

RREZIQUET DHE EMERGJENCAT CIVILE NË KOLONJË

- Bashkia Kolonjë përballet me një shumëlojshmëri rreziqesh të fatkeqësive natyrore e ato të shkaktuara nga njerëzit, ku më të zakonshmet janë:
- zjarret në pyje e kullota;
 - bllokimi i rrugëve nga dëbora;
 - tërmetet, Kolonjë vlerësohet me potencial sismik intensiv;
 - ndryshimi i regjimit të reshjeve;
 - përmbytjet nga shirat;
 - rrëshqitjet e tokës;
 - ndryshimet klimatike të manifestuara me rritje temperature;
 - emergjencat shëndetësore, si rasti i COVID-19.

Kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara duhet të jenë të përgatitur për të dhënë ndihmën e nevojshme në rast emergjencave.

Informacioni dhe shërbimet e dhëna në rast të fatkeqësive dhe emergjencave duhet të jenë plotësish të arritshme për personat me aftësi të kufizuara në situatat para, gjatë dhe pas fatkeqësisë.



Interreg - IPA CBC

Greece - Albania
4PLUS



INTERREG IPA II CROSS-BORDER
COOPERATION PROGRAMME
"GREECE - ALBANIA 2014 - 2020"

Projekti: Ndërgjegjësimi Publik, Gatishmëria, Pjesëmarrja dhe Koordinimi për një Mbrojtje Civile Gjithëpërfshirëse - **4PLUS**


PARTNERËT



Instituti i Kërkimeve Urbane



Bashkia Kolonjë



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë



Konfederata Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar, Greqi



Unioni Rajonal i Komunave të Ishujve të Jonit



Unioni Rajonal i Komunave të Maqedonisë Perëndimore

Ndërgjegjësimi Publik,
Gatishmëria, Pjesëmarrja
dhe Koordinimi për një
Mbrojtje Civile
Gjithëpërfshirëse
4PLUS

